

KONVENTA E PARISIT PËR MBROJTJEN E PRONËSISË INDUSTRIALE NGA 30 MARS I VITIT 1883

Rishikuar në Bruksel më 14 dhjetor të vitit 1900, në Uashington më 2 qershor të vitit 1911, në Hagë më 6 nëntor të vitit 1925, në Londër më 2 qershor të vitit 1934, në Lisbonë më 31 tetor të vitit 1958, në Stokholm më 14 korrik të vitit 1967

Shpallur në “Gazetën zyrtare të RM-së.” nr. 5/74

Neni 1

1) Shtetet ndaj të cilave zbatohet kjo konventë përbëjnë Unionin për mbrojtje të pronësisë industriale.

2) Mbrojtja e pronësisë industriale ka për lëndë patentat, modelet për shfrytëzim, mostrat apo modelet industriale, markat tregtare apo të fabrikuara, markat tregtare shërbyese, emrat tregtarë dhe shenjat apo emrat e origjinës, si edhe largimin e konkurrencës jolojale.

3) Pronësia industriale nënkuptohet në kuptimin më të gjerë dhe ka të bëjë jo vetëm me industrinë dhe tregtinë në kuptimin e plotë të fjalës, por edhe me degët e industrisë bujqësore dhe ekstraktive dhe ndaj të gjitha produkteve të fabrikuara apo natyrore si për shembull: vena, drithëra, gjethet e duhanit, pemët, bagëtinë, mineralet, ujërat minerale, birra, lulet, mielli.

4) Për patenta nënkuptohen lloje të ndryshme të patentave industriale të zbatuara nga ligjvënësi i vendeve të Unionit si patenta të importit, patenta për përsosmëri, patenta dhe certifikata plotësuese e kështu me radhë.

Neni 2

1) Anëtarët e secilit nga vendet e Unionit do të gëzojnë në vendet e tjera të Unionit, nëse është në pyetje mbrojtja e pronësisë industriale, dobi që ligjet adekuate tani ua japin shtetasve të tyre apo do t'i japin në mënyrë plotësuese, por me këtë të mos shkelen të drejtat veçanërisht të parapara me këtë konventë. Sipas kësaj, ata do të kenë mbrojtje të njëjtë sikur edhe këta dhe mjet të njëjtë juridik kundër çdo shkeljeje që i bëhet të drejtave të tyre, me këtë të plotësohen kushtet dhe formalitetet që kërkohen edhe nga shtetasit e tyre.

2) Megjithatë, asnjë kusht i vendasit (domicilit) apo i ndërmarrjes në vendin në të cilin kërkohet mbrojtje nuk mund të kërkohet nga anëtari i Unionit, që të gëzohet në ndonjë nga të drejtat e pronësisë industriale.

3) Shprehimisht përjashtohen dispozitat e ligjvënësimit të çdo vendi nga vendet e Unionit, që kanë të bëjnë me procedurën gjyqësore apo administrative dhe të kompetencës, si edhe të zgjedhjes së vendasit apo përcaktimit të përfaqësuesit, nëse do të kërkohet me ligjet për pronësi industriale.

Neni 3

Me anëtarët e vendeve të Unionit barazohen anëtarët e vendeve që nuk i takojnë Unionit, e të cilët kanë vendqëndrim apo kanë ndërmarrje faktike dhe serioze industriale apo tregtare në territorin e njërit nga vendet e Unionit.

Neni 4

A-1) Ai që do të dorëzojë aplikacion (fletëparaqitje) të rregullt për patentë, model për shfrytëzim, mostër apo model industrial, markë tregtare apo fabrikimi në njërin nga vendet e Unionit, apo pranuesit të tij të të drejtave, gjatë dorëzimit të fletëparaqitjes adekuate në vend tjetër do të gëzojë të drejtën e përparësisë gjatë kohës së afateve të caktuara më poshtë.

2) Pranohet se e drejta e përparësisë është e bazuar me dorëzimin e çdo fletëparaqitjeje që do të konsiderohet si e rregullt sipas legjislacionit nacional të çdo vendi të Unionit apo sipas marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe të lidhura midis vendeve të Unionit.

3) Si fletëparaqitje e rregullt nacionale duhet të nënkuptohet çdo fletëparaqitje nga e cila mund të vërtetohet data e dorëzimit në vendin adekuat, sido që të ketë qenë fati i më vonshëm i kësaj fletëparaqitjeje.

B-1) Sipas kësaj, lutja e dorëzuar në mënyrë plotësuese në një vend tjetër të Unionit para skadimit të këtyre afateve, nuk e humb vlerën e saj juridike me veprimet e kryera në ndërkohë, e veçanërisht me dorëzimin fletëparaqitjes tjetër, me publikim të shpikjes apo me shfrytëzimin e tij, me shitje të shembujve të mostrave apo modeleve, apo me përdorimin e markës tregtare, kurse me këto veprime personat e tretë nuk mund të themelojnë asnjë të drejtë e as pronësi. Të drejtat e personave të tretë të fituara para ditës së dorëzimit të fletëparaqitjes së parë që shërben si bazë për të drejtën e përparësisë sigurohet me legjislacionin e brendshëm të çdo vendi të Unionit.

C-1) Afatet e lartë caktuara e të drejtës së përparësisë janë 12 muaj për patenta dhe modele për shfrytëzim kurse gjashtë muaj për mostra dhe modele industriale, si edhe për marka tregtare dhe të fabrikuara.

2) Këto afate fillojnë të rrjedhin nga data e dorëzimit të fletëparaqitjes s[ë parë në një vend të Unionit. Dita e dorëzimit të fletëparaqitjes nuk konsiderohet në afat.

3) Nëse dita e fundit e afatit është një ditë e festës së përcaktuar me ligj apo ditë kur Drejtoria nuk është e hapur për pranimin e fletëparaqitjeve në vendin në të cilin kërkohet mbrojtje afati do të vazhdohet deri në ditën e parë të ardhshme.

4) Si fletëparaqitje e parë, nga dita e dorëzimit të së cilës fillon të rrjedhë afati i të drejtës së përparësisë, do të konsiderohet edhe fletëparaqitja e më vonshme që ka të bëjë me lëndën e njëjtë si edhe ndonjë fletëparaqitje e parë e më pashme në kuptimin e pikës 2 të lartshënuar, të dorëzuar në vendin e njëjtë të m Unionit, me kusht që në ditën e dorëzimit të fletëparaqitjes së më vonshme fletëparaqitja e më hershme të jetë tërhequr, braktisur apo refuzuar, e të mos ketë qenë e parë nga publiku, të mos jenë themeluar me të disa të drejta, si dhe veç më të mos ketë shërbyer si bazë për kërkesë të së drejtës së përparësisë. Në këtë rast fletëparaqitja e më hershme nuk do të mund të shërbejë si bazë për kërkimin e të drejtës së përparësisë.

Ç-1) Ai që do të dëshironte të shfrytëzojë të drejtën e përparësisë së

fletëparaqitjes së dorëzuar më herët, është i obliguar të dorëzojë deklaratë me përcaktimin e datës dhe vendit të asaj fletëparaqitjeje. Çdo vend do të përcaktojë Deri kur më së voni duhet patjetër të dorëzohet kjo deklaratë.

2) Këto të dhëna do të shënohen në publikimet, që i boton administrata kompetente, e veçanërisht ndaj patentave dhe përshkrimeve adekuate.

3) Vendet e Unionit do të mund të kërkojnë nga ai që dorëzon deklaratë për të drejtën e përparësisë që të dorëzojë kopje të aplikacionit (përshkrim, draft etj.) që është dorëzuar më herët. Kopja e vërtetuar nga administrata që e ka pranuar atë fletëparaqitje se i është besnik origjinalit, do të lirohet nga vërtetimi tjetër dhe do të mund, në çdo rast, të dorëzohet, i liruara nga taksat, në çfarëdo kohe në afat prej tre muajsh, duke numëruar nga dita e dorëzimit të fletëparaqitjes së mëvonshme. Do të mund të kërkohej dhe të i dorëzohet vërtetim për datën e dorëzimit të fletëparaqitjes, e lëshuar nga kjo administratë si edhe përkthim.

4) Nuk mund të kërkohej formalitete të tjera për deklaratën e të drejtës së përparësisë gjatë kohës së dorëzimit të fletëparaqitjes. Secili vend i Unionit do ti përcaktojë pasojat nga mos plotësimi i formaliteteve të parapara me këtë nen, me atë që ato pasoja të mos mund të japin më tej nga humbja e të drejtës së përparësisë.

5) Në mënyrë plotësuese mund të kërkohej edhe dëshmi të tjera.

Ai i cili thirret në të drejtën e përparësisë në ndonjë prej fletëparaqitjeve të mëparshme ka për obligim që të shkruajë numrin e kësaj fletëparaqitjeje. Kjo deklaratë do të publikohet nën kushtet e parapara me pikën e lartshënuar 2.

D-1) Kur ndonjë mostër apo model industrial do të ishte paraqitur në ndonjë vend me të drejtë të përparësisë, në bazë të aplikacionit të modelit të shfrytëzimit, afati i përparësisë do të jetë ai që është përcaktuar për mostrat apo modelet industriale.

2) Përveç kësaj, është e lejuar në një vend që të paraqitet model për shfrytëzimin e së drejtës së përparësisë në bazë të aplikacionit të dorëzuar të patentës dhe e kundërta.

DH-1) Asnjë vend i Unionit nuk mund të refuzojë të drejtën e përparësisë ose paraqitjen e patentës për shkak të asaj që aplikuesi kërkon të drejta të shumëfishta të përparësisë, madje edhe nga shtete të ndryshme, ose për atë që ndonjë aplikacion me të cilin kërkohej një ose më shumë të drejta të përparësisë që nuk ishin përfshirë me aplikacion ose aplikacione, e drejta e të cilave kërkohej, me kusht, që në të dy rastet, të ekzistojë unitet për shpikjen në kuptimin e ligjit të atij vendi.

Në raport me elementët që nuk janë të përfshirë me aplikacion ose aplikacionet, e drejta e përparësisë të cilave kërkohej me dorëzimin e aplikacionit të mëvonshëm, e drejta e përparësisë bazohet nën kushte të rregullta.

3-1) Nëse me ekzaminime tregohet se aplikacioni për patentë është kompleks, aplikuesi mund ta ndajë atë në numër të caktuar të aplikacioneve të veçanta duke mbajtur si datë në secilën prej tyre datën e aplikacionit fillestar, dhe nëse ka bazë, përfitimin e së drejtës së përparësisë.

2) Aplikuesi gjithashtu do të mund, me iniciativë të vet, të ndajë aplikacionin për patentë, duke mbajtur si datë për secilën aplikacion të ndarë datën e aplikacionit fillestar dhe, nëse ka bazë, edhe përfitimet e përparësisë. Çdo vend i Unionit do të mund të përcaktojë kushtet përmes të cilëve mund të miratohet kjo ndarje.

E-1) E drejta e përparësisë nuk mund të refuzohet për atë se disa elementë të shpikjes për të cilën kërkohet e drejta e përparësisë nuk gjenden në kërkesat e formuluarat të aplikacionit, në vendin e prejardhjes, nëse nga të gjitha pjesët përbërëse të aplikacionit këto elementë mund të zbulohen në mënyrë të qartë.

F -1) Me aplikacionet e certifikatave të shpikjeve të dorëzuara në vendin ku aplikuesit kanë të drejtë, sipas zgjedhjes së tyre të kërkojnë qoftë patentë, qoftë certifikatë për shpikje, do të fitohet e drejta e përparësisë e bazuar në këtë nen nën kushte të njëjta sikur me aplikacionet për patenta.

2) Në vendin ku aplikuesit kanë të drejtë, sipas zgjedhjes së tyre, të kërkojnë qoftë patentë, qoftë certifikatë për shpikje, aplikuesi për certifikatë të shpikjes do të gëzojë, sipas dispozitave të këtij neni që zbatohen mbi aplikacionet për patentë, të drejtën e përparësisë të bazuar me dorëzimin e aplikacionit për patentë, model për shfrytëzim apo certifikatë për shpikje.

Neni 4 bis

1) Patentat e kërkuara nga anëtarë i unionit në vende të ndryshme të Unionit janë të pavarura nga patentat e fituara për të njëjtën shpikje në shtete të tjera, që i takojnë ose jo Unionit.

2) Kjo dispozitë duhet të kuptohet në kuptimin e plotë, d.m.th. ashtu që patentat e kërkuara në afatin e së drejtës së përparësisë të jenë të pavarura, si në aspekt të shkaqeve të anulimit apo humbjes së vlefshmërisë, ashtu edhe në aspekt të kohëzgjatjes normale.

3) Kjo aplikohet për të gjitha patentat ekzistuese në momentin e hyrjes së saj në fuqi.

4) E njëjta gjë vlen ehe në rast të aderimit të vendeve të reja për patentat ekzistuese të dy palëve në kohën e aderimit.

5) Patentat e fituara me përfitim të së drejtës së përparësisë do të gëzojnë në vende të ndryshme të Unionit, kohëzgjatje (vlefshmëri) të barabartë me kohëzgjatjen që do ta gëzonin sikur të ishin kërkuar apo lëshuar pa përfitim të së drejtës së përparësisë.

Neni 4 ter

Shpikësi ka të dejtë si i tillë të evidentohet në patentë.

Neni 4 quater

Lëshimi i patentës nuk mund të refuzohet dhe patenta nuk mund të anulohet sepse shitja e produktit të mbrojtur me patentë ose të fituar me procedurë të mbrojtur i është nënshtruar ndalesave ose kufizimeve që dalin nga legjislacioni nacional.

Neni 5

A-1) Importimi i lëndëve të përpunuara në një ose shtet tjetër të Unionit, nga ana e bartësit të patentës, në vendin në të cilin patenta është lëshuar, nuk i nënshtrohet humbjes së të drejtës.

2) Secili nga vendet e Unionit ka mundësi të përdorë masat e nevojshme ligjore me të cilat parashihet dhënia (lëshimi) i licencave të detyruara, për të parandaluar keqpërdorimet që mund të ndodhin me shfrytëzimin e së drejtës ekskluzive të dhënë me patentë, për shembull me mospërdorim (mosshfrytëzim).

3) Nuk mund të parashikohet tërheqja (marrja) e patentës përveç në raste kur lëshimi i licencave të detyruara (sforcuara) nuk do të ishte i mjaftueshëm për të parandaluar këto keqpërdorime. Nuk mund të dorëzohet asnjë lloj kërkesë për marrjen ose shfuqizimin e patentës para skadimit të periudhës prej dy viteve, duke llogaritur nga data e dhënies së licencës së parë të detyruar.

4) Lëshimi i licencave të detyruara nuk mund të kërkohet për shkak të mosshfrytëzimit ose shfrytëzimit të pamjaftueshëm para skadimit të afatit prej katër viteve nga data e dorëzimit të aplikacionit për patentë, ose tre viteve nga data e lëshimit të patentës, me atë që duhet të aplikohet ai afat që skadon më vonë; Kjo do të refuzohet nëse bartësi i patentës e arsyeton mosshfrytëzimin me arsye ligjore. Licenca e tillë e detyruar nuk do të jetë përjashtuese dhe nuk do të mund të bartet mbi tjetrin madje edhe në lloj të nënlicencës, përveç me pjesë të ndërmarrjes ose fondit tregtar (fond dy komes) në të cilin përdoret kjo licencë.

5) Dispozitat që paraprijnë do të zbatohen me kusht të ndryshimeve të domosdoshme, mbi modelet për shfrytëzim.

B-1) Mbrojtja e mostrave dhe modeleve industriale nuk mund të ndikohet me asnjë ndërprerje, qoftë për shkak të shfrytëzimit, qoftë për shkak të importit të artikujve që janë të njëjtë sikur artikujt e mbrojtur.

C-1) Nëse në ndonjë vend përdorimi i shenjës (markës) së regjistruar është i detyrueshëm, regjistrimi mund të anulohet vetëm përmes një afati të drejtë dhe nëse i interesuari nuk i arsyeton shkaqet për mospunimin (mosfunksionimin) e tij.

2) Përdorimi i shenjave tregtare ose fabrikimi nga ana e pronarit, në pamje që sipas elementëve nuk e ndryshojnë karakterin dallues të shenjës dallon nga pamja në të cilin ato janë regjistruar në ndonjë nga vendet e Unionit, nuk do të ketë për pasojë anulimin e regjistrimit të saj, e as që do të zvogëlojë mbrojtjen e miratuar për atë shenjë.

3) Shfrytëzimi i njëkohshëm i shenjës së njëjtë të produkteve që të llojit të njëjtë ose që ngjasojnë nga ana e ndërmarrjeve industriale apo tregtare që konsiderohen si pronarë të shenjës sipas dispozitave të legjislacionit nacional të vendit në të cilin kërkohet mbrojtja, nuk do të pengojë regjistrimin e as që do të zvogëlojnë në çfarëdo mënyre mbrojtjen e miratuar për atë lloj në cilindo qoftë shtet të Unionit, vetëm nëse përdorimi i tillë nuk do të ketë atë veprim që ta sjellë publikun në huti, edhe pse nuk është në kundërshtim me interesi publik.

D – Për njohje të së drejtës nuk do të kërkohet asnjë shenjë as shënim për patentë, model për shfrytëzim, regjistrim të shenjës fabrikimi ose tregtare ose aplikacion për mostër ose model industrial.

Neni 5 bis

1) Një afat shtesë, që duhet të jetë së paku gjashtë muaj, do të jepet për pagesën e taksave të parashikuara për mirëmbajtjen e së drejtës së pronësisë industriale, gjatë pagesës së taksave shtesë, nëse legjislacioni vendor kërkon një taksë të tillë.

2) Vendet e Unionit mund të parashikojnë kthimin (aktivizimin) e patentave që kanë pushuar të vlejnjë për shkak të mospagesës së taksave.

Neni 5 ter

Në secilin nga vendet e Unionit nuk do të konsiderohet se i shkel të drejtat e bartësit të patentës:

1) shfrytëzimi i mjeteve, që janë lëndë e patentës së tij të anijeve nga vende të tjera të Unionit në trupin e anijes, në makineritë, pajisjet, aparatet dhe aksesoret tjerë, kur ato anije do të hynin përkohësisht ose rastësisht në ujërat e vendit në fjalë, me kusht që ato mjete të përdoren këtu ekskluzivisht për përdorim në anije.

2) përdorimi i mjeteve, që përbëjnë lëndë të patentës, në konstruksione ose në funksionimin e krijimeve për lëvizje në ajër ose për tokë nga vende të tjera të Unionit, ose me aksesoret e këtyre aparateve, kur këto do të kishin hyrë përkohësisht ose rastësisht në atë vend.

Neni 5 quater

Kur ndonjë produkt do të importohet në vendin e Unionit për të cilin ekziston patentë me të cilin mbrohet procedura e prodhimit të këtij produkti, sipas këtij produkti bartësi i patentës do t'i ketë të gjitha të drejtat që, në bazë të procedurës së mbrojtjes, i siguron legjislacioni i vendit të importit në raport me produktet e përpunuara në vetë atë vend.

Neni 5 quinquies

Mostrat dhe modelet industriale do të mbrohen në të gjitha vende e Unionit.

Neni 6

1) Kushtet për aplikim ose regjistrim të shenjave fabrikimi ose tregtare do t'i përcaktojë çdo vend me legjislacion të vetë nacional.

2) Megjithatë, shenja që anëtari i ndonjë vendi të Unionit do të aplikojë në cilindo vend të Unionit, nuk do të mund të refuzohet ose anulohet vetëm për shkak të arsyes se nuk është aplikuar, regjistruar ose shpallur në vendin e prejardhjes.

3) Shenja që është regjistruar në mënyrë të rregullt në ndonjë vend të Unionit do të konsiderohet si e pavarur nga shenjat e regjistruara në vendet tjera të Unionit, duke nënkuptuar këtu edhe vendin e prejardhjes.

Neni 6 bis

1) Vendet e Unionit obligohen, qoftë sipas detyrës zyrtare, nëse e lejon legjislacioni i atij vendi, qoftë me kërkesë të palës së interesuar, të refuzojnë ose anulojnë regjistrim dhe ndalesë të përdorimit të shenjës fabrikimi ose tregtare që përfaqëson riprodhim, mbështetje ose përkthim, ashtu i realizuar që të mund të krijojë konfuzion me ndonjë shenjë që autoriteti përkatës i vendit të regjistrimit ose përdorimit do të konsideronte se në atë vend padyshim është i njohur si shenjë e personit që gëzon të drejtën për ta përdorur me këtë konventë dhe të përdoret në produkte të llojit të njëjtë ose të ngjashëm.

Në të njëjtën mënyrë do të procedohet edhe nëse pjesa e rëndësishme e shenjës përfaqëson riprodhim të ndonjë shenje të tillë që padyshim është i

njohur ose mbështetje që mund të krijojë konfuzion me atë shenjë.

2) Një afat më i shkurtë, prej pesë viteve, duke llogaritur nga data e regjistrimit, duhet të jepet për kërkesë për fshirjen e shenjës së tillë. Vendet e Unionit mund të parashikojnë një afat në të cilin mund të kërkohej ndalesë përdorimi.

3) Nuk do të përcaktohet afat për kërkesë për fshirje ose ndalesë përdorimi të shenjave të regjistruara ose të përdorura me qëllim të keq.

Neni 6 ter

1)a) Vendet e Unionit pajtohen që në mungesë të lejes nga autoritetet përkatëse, të refuzojnë ose anulojnë regjistrimin dhe të ndalojnë, me mjete adekuate, përdorimin e cilitdo lloj të shenjave fabrikimi ose tregtare, qoftë sikur pjesë përbërëse e këtyre shenjave, emblemave, flamujve dhe emblemave të tjera shtetërore të vendeve të Unionit, shenjave zyrtare dhe shenjave për kontroll dhe garanci, që i kanë miratuar ata, si dhe çdo mbështetje në dukje heraldike.

b) Dispozitat nga pika a) zbatohen gjithashtu mbi emblemat, flamujt dhe simbolet tjera, shkurtesat ose emërtimet e organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare, anëtarët e të cilëve janë një ose më shumë vende të Unionit, me përjashtim të emblemave, flamujve dhe simboleve tjera, shkurtesat ose emërtimet që vetëm se kanë qenë lëndë e marrëveshjeve të vlefshme ndërkombëtare me qëllim sigurimin e mbrojtjes së tyre.

c) Asnjë vend i Unionit nuk do të jetë i obliguar të zbatojë dispozitat e cekura në pikën e mësipërme b) në dëm të bartësve të së drejtave të realizuara me qëllim të mirë, para hyrjes në fuqi të kësaj konvente në atë vend. Vendet e Unionit nuk janë të obliguara të zbatojnë këto dispozita kur përdorimi i tyre ose regjistrimi nga pika e mësipërme a) nuk është e natyrës së tillë që publikun ta çojë në mendime se ekziston ndonjë lidhje midis organizatës në pyetje dhe emblemave, flamujve simboleve, shkurtesave apo emërtimeve, ose kur nuk është e besueshme se ky përdorim ose ky regjistrim është i tillë që të mund të sjellë publikun në huti (konfuzion) për ekzistimin e ndonjë lidhje midis shfrytëzuesit dhe organizatës.

2) Ndalesa e shenjave zyrtare dhe shenjave (punceve) për kontroll ose garanci do të zbatohet vetëm në rastet kur shenjat, që do t'i përmbanin, do të ishin të destinuara të përdoren në mallra të llojit të njëjtë ose të ngjashëm.

3)a) Për zbatimin e këtyre dispozitave vendet e Unionit pajtohen t'i dorëzojnë njëri tjetrit, përmes Byrosë ndërkombëtare, listë të emblemave shtetërore, shenjave zyrtare dhe shenjave (puceve) për kontroll dhe garanci, që ata duan ose do të dëshironin t'i vendojnë, pa kufizime ose në kufij të caktuar, nën mbrojtjen nga ky nen, si edhe çdo ndryshim i ardhshëm i kryer në këtë listë. Çdo vend i Unionit do t'i vë me kohë në dispozicion për publikun listat e dorëzuara.

Ky njoftim, megjithatë, nuk është i obligueshëm kur janë në pyetje flamujt shtetëror.

b) Dispozitat nga pika b) të paragrafit 1 të këtij neni zbatohen vetëm mbi emblemat, flamujt dhe simbolet tjera, shkurtesat ose emërtimet e organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare, që këto organizata i kanë njoftuar vendet e Unionit përmes Byrosë ndërkombëtare.

4) Çdo shtet i Unionit do të mund, pas afatit prej dymbëdhjetë muajve nga pranimi i njoftimit, t'i dorëzojë vendit të interesuar ose organizatës ndërkombëtare ndërqeveritare, përmes Byrosë ndërkombëtare, vërejtje të veta eventuale.

5) Për flamujt shtetëror masat e parashikuara në paragrafin e mësipërm 1 do të zbatohen vetëm mbi simbolet e regjistruara pas 6 nëntorit të vitit 1975.

6) Sa i përket emblemave të tjera shtetërore, përveç flamujve, shenjave zyrtare dhe shenjave (puncave) të vendeve të Unionit dhe emblemave, flamujve dhe simboleve tjera, shkurtesave ose emërtimeve të organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare, këto dispozita do të zbatohen vetëm mbi shenjat e regjistruara gjatë kohës më shumë se dy muaj pas pranimit të njoftimit të paraparë me paragrafin e mësipërm 3.

7) Në rast të qëllimit të keq, vendet do të kenë mundësi t'i fshijnë madje edhe shenjat e regjistruara para 6 nëntorit të 1925 në qoftë se përmbajnë emblema, shenja dhe punce.

8) Shtetasit e çdo shteti që janë autorizuar të shfrytëzojnë emblemat shtetërore, shenjat apo puncet e vendit të tyre, do të mund t'i shfrytëzojnë, madje edhe nëse kanë ngjashmëri me ato të ndonjë vendi tjetër.

9) Vendet e Unionit obligohen ta ndalojnë në tregti përdorimin e palejuar të simboleve shtetërore të vendeve të Unionit, kur ky përdorim do të ishte i natyrës së tillë që të sjellë në huti për prejudhjen e produktit.

10) Dispozitat e mësipërme nuk i pengojnë vendet të refuzojnë ose të vënë jashtë zbatimit, me zbatimin e pikës 3 nën pjesa B të nenit 6 quinqis, shenjat që përmbajnë pa leje emblema, flamuj dhe simbole të tjera ose shenja zyrtare ose punce të zbatuara nga një vend i Unionit, si edhe shenjat dalluese të organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare të cekura në paragrafin e mësipërm 1.

Neni 6 quater

1) Kur, në pajtim me legjislacionin e ndonjë vendi të Unionit, bartja e shenjës është e plotë vetëm nëse kryhet njëkohësisht edhe bartja e ndërmarrjes ose fondit tregtar (*fond de commerce*) të cilit i takon shenja, është e mjaftueshme, që të njihet vlefshmëria e saj, pjesa e ndërmarrjes ose fondit tregtar që gjendet në atë vend të bartet mbi cesionarin (përfituesin) me ët drejtë ekskluzive në të të përpunojë ose shesë produkte mbi të cilat vendoset shenja e bartur.

2) Kjo dispozitë nuk i obligon vendet e Unionit ta konsiderojnë si të vlefshme atë bartje të ndonjë shenje përdorimi i së cilës nga ana e cesionarit do

të ishte në esencë e tillë që do të çonte në huti publikun, sidomos në lidhje me prejardhjen, llojin ose cilësitë e rëndësishme të produkteve mbi të cilat vendoset ajo shenjë.

Neni 6 quinques

A-1) Çdo shenjë fabrikimi ose tregtare e regjistruar në mënyrë të rregullt në vendin e prejardhjes do të mund të paraqitet dhe të mbrohet ashtu siç është në vendet tjera të Unionit nën kushte të cekura në këtë nen. Para se të qasen drejt regjistrimit përfundimtar, këto vende do të mund të kërkojnë dorëzimin e certifikatës për regjistrim në vendin e prejardhjes, të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse. Asnjë vërtetim nuk do të kërkohet për certifikatë të tillë.

2) Do të konsiderohet si vend i prejardhjes ai vend i Unionit në të cilin aplikuesi ka ndërmarrje serioze dhe faktike industriale apo tregtare, e nëse nuk ka ndërmarrje të tillë në Union, vendi i Unionit në të cilin ai ka vendbanim, e nëse nuk ka vendbanim në vendin e Unionit, vendi i shtetësisë së tij në rast se ai është anëtarë i një prej vendeve të Unionit.

B-1) Nuk do të mund të refuzohet regjistrimi e as anulimi i shenjës së fabrikimit ose tregtare nga ky nen, përveç në rastet:

1. kur janë të natyrës së tillë që të mund t'i shkaktojnë dëme të drejtave të garantuara nga personat e tretë në vendin prej ku kërkohet mbrojtja;

2. kur janë pa asnjë karakteristikë dalluese ose të përbëra tërësisht nga shenja që do të mund të tregojnë në tregti lloj, cilësi, sasi, qëllim, vlerë, vend të prejardhjes së produktit ose afatin e prodhimit, ose që janë bërë të zakonshme në të folurit e zakonshëm ose në shprehitë e rregullta dhe të konstante të tregtisë nga vendi prej ku është kërkuar mbrojtja;

3. kur i kundërvihet moralit ose rendit publik, e sidomos kur ato mund ta lajthitin publikun. Është përcaktuar se një shenjë nuk do të konsiderohet si kundër rendit publik për arsye të thjeshtë që nuk i përgjigjet ndonjë dispozite të legjislacionit të shenjave, duke përjashtuar rastin kur edhe vetë ajo dispozitë ka të bëjë me rendin publik.

Gjatë gjithë kësaj do të kihet parasysh zbatimi i nenit 10 bis.

C-1) Për të vlerësuar se një shenjë është e përshtatshme për mbrojtje, do të merren parasysh të gjithë rrethanat faktike, e sidomos kohëzgjatja e përdorimit të shenjës.

2) Nuk mund të refuzohen në vendet e Unionit shenjat e fabrikimit ose ato tregtare nga shkaku i thjeshtë që shenjat, të mbrojtura në vendin e prejardhjes, dallojnë vetëm sipas elementëve që nuk e ndryshojnë karakteristikën e tyre dalluese dhe nuk e lëndojnë identitetin e shenjave në atë formë në të cilën janë regjistruar në vendin e cekur të prejardhjes.

D- Askush nuk mund të përdorë dispozitat e këtij neni, nëse shenja,

mbrojtja e së cilës kërkohet, nuk është e regjistruar në vendin e prejardhjes.

E- Megjithatë, në asnjë rast rinovimi i regjistrimit të ndonjë shenje sipas vendit të prejardhjes nuk do të mund të tërheq pas vete obligimin për të rinovuar regjistrimin në vendet tjera të Unionit në të cilët ajo shenjë është regjistruar.

F- Përfitimi i së drejtës së përparësisë mbetet i realizueshëm për shenjat e paraqitura në afatin nga neni 4, madje edhe kur regjistrimi në vendin e prejardhjes do të ndodhte pas skadimit të këtij afati.

Neni 6 sexies

Vendet e Unionit obligohen t'i mbrojnë shenjat e shërbimeve. Ata jo domosdoshmërisht duhet të parashohin regjistrimin e këtyre shenjave.

Neni 6 septies

1) Nëse përfaqësuesi i atij që është bartës i së drejtës së shenjës në një vend të Unionit kërkon, pa autorizim nga ai bartës i së drejtës, regjistrimin e asaj shenje në emër të tij në një ose më shumë nga ato vende, bartësi i së drejtës mund t'i kundërvihet regjistrimit të kërkuar ose të kërkojë fshirjen nga shenja, respektivisht, nëse ligji i vendit e lejon një gjë të tillë, bartjen e regjistrimit në emër të tij, nëse ky përfaqësues nuk i arsyeton veprimet e tij.

2) Bartësi i së drejtës së shenjës do të ketë të drejtë t'i kundërvihet përdorimit të shenjës së tij nga ana e përfaqësuesit ose të autorizuarit të tij, nën kushtet nga paragrafi i sipërm 1, nëse nuk ka dhënë autorizim të vet për këtë përdorim.

3) Legjislacionet nacionale mund të parashikojnë afat të arsyeshëm në të cilin bartësi i së drejtës së shenjës duhet t'i kërkojë të drejtat e tij të parapara me këtë nen.

Neni 7

Natyra e produkteve mbi të cilët vendoset shenjë fabrikimi ose tregtare, në asnjë rast nuk duhet të konsiderohet si regjistrim i shenjës.

Neni 7 bis

1) Vendet e Unionit obligohen të regjistrojnë dhe të mbrojnë shenjat kolektive, që i takojnë shoqatave ekzistimi i së cilave nuk është në kundërshtim me ligjin e vendit të prejardhjes. Madje edhe atëherë kur shoqatat nuk kanë ndërmarrje tregtare apo industriale.

2) Çdo vend do t'i përcaktojë kushtet e veçanta nën të cilat do të mbrohet shenja kolektive dhe ai mund të refuzojë mbrojtjen nëse shenja e tillë është kundër interesit publik.

3) Megjithatë, mbrojtja e shenjave të tilla nuk mund të refuzohet për asnjë shoqatë ekzistimi i së cilës nuk e kundërshton ligjin e vendit të prejardhjes, për shkak se nuk ka ndërmarrje në vendin në të cilin kërkon mbrojtje ose për atë nuk është vendosur në përputhje me legjislacionin e atij vendi.

Neni 8

Emri tregtar do të mbrohet në të gjitha vendet e Unionit, pa obligim për aplikim ose regjistrim, qoftë nëse përbën pjesë ose jo të ndonjë shenje fabrikimi ose tregtare.

Neni 9

1) Çdo produkt që bartë pa të drejtë një shenjë fabrikimi ose tregtare, ose që është një emër tregtar, do të konfiskohet (sekuestruhet) gjatë importit në ato vende të Unionit, në të cilat kjo shenjë ose ky emër tregtar ka të drejtën e mbrojtjes tregtare.

2) Gjithashtu, konfiskimi do të kryhet në vendin në të cilin lëshimi pa të drejtë i shenjës ose emrit është kryer ose në vendin në të cilin produkti do të importohet.

3) Konfiskimi do të kryhet me kërkesë të prokurorit publik, qoftë nga ndonjë autoritet tjetër përgjegjës, qoftë nga ndonjë palë e interesuar, person fizik apo juridik, sipas legjislacionit të brendshëm të çdo vendi.

4) Qeveritë nuk janë të obliguara të kryejnë konfiskim në rast të transitit.

5) Nëse legjislacioni i ndonjë vendi nuk zbaton konfiskim gjatë importit, konfiskimi do të zëvendësohet me ndalesë për import ose me sekuestrimin në brendi të vendit.

6) Nëse legjislacioni i ndonjë vendi nuk zbaton as konfiskim gjatë importit, as ndalesë për import, e as konfiskim në brendi të vendit, e në pritje të asaj se ky legjislacion do të ndryshojë, këto masa do të zëvendësohen me mënyrat dhe mjetet që i siguron ligji i vendit amë në rast të njëjtë për shtetasit e tij.

Neni 10

1) Dispozitat nga neni i mëparshëm do të zbatohen në rast të përdorimit

të drejtpërdrejt ose indirekt të ndonjë shenje të rëndësishme që ka të bëjë me prejardhjen e produktit ose identitetin e prodhuesit, fabrikuesit ose tregtarit.

2) Do të konsiderohet në çdo rast si palë e interesuar, edhe atë qoftë person fizik apo juridik, çdo prodhues, fabrikues ose tregtarë, që merr pjesë në prodhim, fabrikim ose tregtim të atij produkti, dhe që është krijuar, qoftë në vendin e shënuar rrejshëm si vend i prejardhjes, qoftë në vend të shënuar rrejshëm, qoftë vend në të cilin është përdorur shenjë e rrejshme e prejardhjes.

Neni 10 bis

1) Vendet e Unionit janë të obliguara t'i sigurojnë anëtarëve të Unionit një mbrojtje faktike kundër konkurrencës jolojale.

2) Akt të konkurrencës jolojale paraqet çdo akt i konkurrencës që është kundër zakoneve të ndershme të industrisë ose tregtisë.

3) Duhet të ndalohet në veçanti:

1. çfarëdo veprash që sipas natyrës së tyre mund të krijojnë huti (konfuzion), me çfarëdo qoftë lidhjesh të jetë, me ndërmarrjet, produktet ose me veprimtarinë industriale respektivisht tregtare të një konkurenti;

2. shënime të rrejshme gjatë udhëheqjes së tregtisë, të natyrës së tillë që diskreditojnë ndërmarrjet, produktet ose veprimtarinë industriale respektivisht tregtare të një konkurenti;

3. shenja ose indikacione përdorimi i të cilave në tregti mund ta çojë publikun në huti për prejardhjen, mënyrën e prodhimit, veçoritë, përfitimet e përdorimit ose sasinë e mallrave.

Neni 10 ter

1) Vendet e Unionit u obligohen anëtarëve të vendeve të tjera të Unionit t'u sigurojnë mjete adekuate juridike për eliminimin e suksesshëm për të gjitha veprimet për të cilat flitet në nenet 9, 10 dhe 10bis.

2) Përveç kësaj, ata obligohen të parashikojnë masa që do t'u mundësonin sindikatave dhe shoqatave që i përfaqësojnë industrialistët, prodhuesit dhe tregtarët e interesuar, dhe ekzistenca e të cilëve nuk është në kundërshtim me ligjet e vendit të tyre, të iniciojnë kontest në gjykatë ose në autoritetet përgjegjëse administrative, me qëllim largimin e veprave të parapara me nenin 9, 10 dhe 10 bis në kufijtë në të cilët ligji i vendit ku është kërkuar mbrojtja ua lejon këtë sindikatave dhe shoqatave nga ai vend.

Neni 11

1) Vendet e Unionit do t'u japin, sipas legjislacionit të tyre të

brendshëm, mbrojtje të përkohshme të shpikjeve të përshtatshme për patentim të modeleve për shfrytëzim të mostrave dhe modeleve industriale, si edhe të shenjave të fabrikimit dhe tregtare për produktet që do të shfaqen në ekspozita ndërkombëtare, të pranuar ose jo zyrtarisht, të organizuar në territorin e njërit prej tyre.

2) Kjo mbrojtje e përkohshme nuk do t'i vazhdojë afatet nga neni 4. Nëse më vonë thirret në të drejtën e përparësisë, administrata e çdo vendi do të mund të llogarisë se afati rrjedh nga data e vendosjes së produktit në ekspozitë.

3) Çdo vend do të mund të kërkojë, si dëshmi për vërtetësinë e produktit të ekspozuar dhe datën e vendosjes, vërtetime që do t'i konsiderojë si të nevojshme.

Neni 12

1) Çdo vend i Unionit obligohet të themelojë drejtori të veçantë për pronësi industriale dhe qendër për informim të publikut për patentat, modelet e shfrytëzimit, mostrat dhe modelet industriale dhe shenjat e fabrikimit dhe tregtare.

2) Kjo drejtori do të publikojë një gazetë zyrtare periodike. Ajo do të shpall rregullisht:

a) Emrat e bartësve të patentave të miratuara, me shënime të shkurt të shpikjeve të mbrojtura;

b) Riprodhimet e shenjave të regjistruara.

Neni 13

1. a) Unioni ka Kuvend të përbërë nga vendet e Unionit të lidhura me nenet nga 13 deri 17.

b) Qeveria e çdo vendi përfaqëson një përfaqësues, të cilit mund t'i ndihmojnë zëvendës, këshilltarë dhe ekspertë;

c) Shpenzimet e çdo përfaqësie i bart qeveria që ka emëruar.

2. a) Kuvendi:

I) diskuton për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit, si dhe zbatimin e kësaj Konvente;

II) I ofron Byrosë ndërkombëtare për pronësi industriale (në tekstin e mëtejshëm: Byroja ndërkombëtare) parashikuar në Konventën për themelimin e Organizatës botërore për pronësi industriale (në tekstin e mëtejshëm: Organizata), udhëzime për përgatitjen e konventave për rishikim, duke mbajtur llogari për vërejtjet nga vendet e Unionit që nuk janë të ndërlidhura me nenet nga 13 deri

17.

III) I shqyrton dhe miraton raportet dhe aktivitetet e drejtorit gjeneral të Organizatës që kanë të bëjnë me Unionin dhe i jep të gjitha udhëzimet e dobishme për çështje në kompetencë të Unionit;

IV) I zgjedh anëtarët e Këshillit ekzekutiv të Kuvendit;

V) i shqyrton dhe miraton raportet dhe punët e Këshillit të tij ekzekutiv dhe i jep udhëzime;

VI) sjell program, miraton buxhetin trevjeçar të Unionit, miraton llogaritë përfundimtare;

VII) formon këshilla të ekspertëve dhe grupe punuese që i konsideron si të dobishme për realizimin e detyrave të Unionit;

VIII) vendos cilët vende që nuk janë anëtarë të Unionit dhe cilat organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare mund të marrin pjesë në mbledhjet e tij në cilësinë e vëzhguesit;

IX) vendos cilët vende që nuk janë anëtarë të Unionit dhe cilat organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare mund të marrin pjesë në mbledhjet e tij në cilësinë e vëzhguesit;

X) i miraton ndryshimet në nenet nga 13 në 17;

XI) ndërmerri gjithçka tjetër që është në të mirë të realizimit të detyrave të Unionit;

XII) i kryen të gjitha detyrat tjera që dalin nga kjo Konventë;

XIII) i kryen, me kusht që t'i pranojë, të drejtat që i janë besuar me Konventën për themelimin e Organizatës:

b) për çështje për të cilat janë të interesuar njësoj edhe unionet tjera me të cilat administron Organizata, Kuvendi vendos pasi që të marrë mendim nga Këshilli koordinues i Organizatës.

3. a) Përveç në rastin nga nënparagrafi b), një përfaqësues mund të përfaqësojë vetëm një vend.

b) Vendet e Unionit që me marrëveshje të veçantë kanë formuar drejtori të veçantë, cila për secilin nga ta ka cilësi të shërbimit të veçantë nacional për pronësi industriale nga neni 12, mund gjatë rrjedhjes së diskutimeve të përfaqësojë në tërësi vetëm njërin prej tyre.

4. a) Çdo vend anëtarë i Kuvendit disponon vetëm me një votë.

b) Kuorumin e përbën gjysma e vendeve anëtare të Kuvendit.

c) Edhe përsëri dispozitave nga nënparagrafi b) nëse gjatë një seance të veçantë, numri i vendeve të përfaqësuara është më i vogël se gjysma por i barabartë ose më i madh se një e treta e anëtarëve të Kuvendit, këta do të mund të sjellin vendime, megjithatë, vendimet e Kuvendit, përveç atyre që kanë të bëjnë me procedurat, do të bëhen të plotfuqishme pasi që do të plotësohen kushtet e cekura më poshtë. Byroja ndërkombëtare i njofton për këto vendime vendet anëtare të Kuvendit që nuk kanë qenë të përfaqësuara, duke i ftuar që të deklarohen me shkrim, në afat prej tre muajve nga dita e njoftimit, mbi atë se japin votën e tyre apo abstenojnë. Nëse pas skadimit të këtij afati numri i vendeve që në këtë mënyrë kanë dhënë votën e tyre ose janë

përmbajtur është të paktën i barabartë me numrin e vendeve që kanë munguar për të arritur kuorumin gjatë seancës, këto vendime do të bëhen të plotfuqishme me kusht që njëkohësisht të jetë arritur shumica e nevojshme.

d) Me përjashtim të paraparë me dispozitat nga neni 17 paragrafi 2, vendimet e Kuvendit sillen me shumicë prej dy të tretave të votave të dhëna.

e) Abstenimi nuk konsiderohet si votë.

5. a) Përveç në rastin nga nënparagrafi b), një përfaqësues mund të votoj vetëm në emër të vendit të tij.

b) Vendet e Unionit nga paragrafi 3 nën b) do të përpiqen, sipas rregullit, në mbledhjet e Kuvendit t'i përfaqësojnë vetë përfaqësitë e tyre. Megjithatë, nëse për shkak të shkaqeve të jashtëzakonshme, një nga këto vende nuk mund të përfaqësojë përfaqësinë e tij, ai mund të autorizojë përfaqësinë e ndonjë vendi tjetër nga këto vende që të votojë në emër të tij, me atë që një përfaqësi në bazë të autorizimeve mund të votojë vetëm për një vend. Çdo autorizim për këtë qëllim duhet të jetë i nënshkruar në akt nga kreu i shtetit ose ministri përgjegjës.

6. Vendet e Unionit që nuk janë anëtarë të Kuvendit marrin pjesë në takimet e tij në cilësinë e vëzhguesit.

7. a) Kuvendi mbledhet në seanca të rregullta një herë në tre vite, në ftesë të drejtorit gjeneral dhe përveç në raste të jashtëzakonshme, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend si edhe Kuvendi gjeneral i Organizatës.

b) Kuvendi mbledhet në seanca të jashtëzakonshme me ftesë të drejtorit gjeneral, e me kërkesë nga Këshilli ekzekutiv ose me kërkesë të një të katërtës së vendeve anëtare të Kuvendit.

8. Kuvendi miraton Rregullore të vet.

Neni 14

1. Kuvendi ka Këshill ekzekutiv.

2. a) Këshilli ekzekutiv është formuar nga vendet që do t'i zgjedh Kuvendi ndër anëtarët e tij. Përveç kësaj, vendi në territorin e të cilit është selia e Organizatës disponon *ex officio*-*oficio*, me një ulëse në Këshill, përveç në rastin e paraparë me nenin 16 paragrafi 7 nën b).

b) Qeverinë e çdo vendi anëtarë të Këshillit ekzekutiv e përfaqëson një përfaqësues, të cilit mund t'i ndihmojnë zëvendës, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Shpenzimet për çdo përfaqësi i bart qeveria që ka bërë emërimin.

3. Numri i vendeve anëtare të Këshillit ekzekutiv është i barabartë me

një të katërtën e vendeve anëtare të Kuvendit. Gjatë llogaritjes së ulëseve që duhet të caktohen, pjesa e mbetur pas ndarjes në katër pjesë nuk merret parasysh.

4. Gjatë përzgjedhjes së anëtarëve në Këshillin ekzekutiv, Kuvendi mban llogari për shpërndarjen e rregullt gjeografike dhe domosdoshmërinë që të gjitha vendet anëtare me aranzhime të veçanta të themeluara në lidhje me Unionin të jenë midis vendeve që e formojnë Këshillin ekzekutiv.

5. a) Anëtarët e Këshillit ekzekutiv i kryejnë obligimet e tyre nga hapja e mbledhjes së Kuvendit për të cilat janë zgjedhur deri në fundin e seancës së ardhshme të rregullt të Kuvendit.

b) Anëtarët e Këshillit ekzekutiv mund të rizgjidhen sërish, por më së shumti dy të tretat ndër ta (prej tyre).

c) Kuvendi i përshkruan mënyrat e zgjedhjes dhe zgjedhjes së përsëritur eventuale të anëtarëve të Këshillit ekzekutiv.

6. a) Këshilli ekzekutiv:

I) Përgatit draft të rendit të ditës së Kuvendit;

II) I dorëzon Kuvendit propozime në lidhje me draftet e programeve dhe buxhetin trevjeçar të Unionit që i ka përgatitur drejtori gjeneral;

III) Deklarohet, në kufijtë e programit dhe buxhetit trevjeçar dhe për buxhetet që i përgatit drejtori gjeneral;

IV) I dorëzon Kuvendit, me vërejtje përkatëse, raporte të kohëpaskohshme nga drejtori gjeneral dhe raporte vjetore për pasqyrën e llogarive.

V) I ndërmerr të gjitha masat e duhura që drejtori gjeneral ta realizoj programin e Unionit në përputhje me vendimet e Kuvendit dhe duke mbajtur llogari për rrethanat e krijuara midis dy seancave të rregullta të këtij Kuvendi;

VI) I kryen të gjitha obligimet që i janë caktuar në kuadër të kësaj konvente.

b) për çështje për të cilat njëloj janë të interesuar edhe unionet tjerë që i administron Organizata, Këshilli ekzekutiv vendos pasi që të njihet me mendimin e Këshillit koordinues të Organizatës.

7. a) Këshilli ekzekutiv mbledhet në seancë të rregullt një herë në vit, me ftesë të drejtorit gjeneral, sipas mundësisë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend si edhe Këshilli koordinues i Organizatës.

b) Këshilli ekzekutiv mbledhet në seancë të jashtëzakonshme me ftesë të drejtorit gjeneral, qoftë me iniciativë të tij, qoftë me kërkesë të presidentit të tij, ose një të katërtës të anëtarëve të tij.

8. a) Çdo vend anëtarë i Këshillit ekzekutiv disponon me një votë.

b) Kuorumin e përbën gjysma e vendeve anëtare të Këshillit

ekzekutiv.

- c) Vendimet sillen me shumicë të thjeshtë nga votat e dhëna.
- d) Abstenimi nuk llogaritet si votë.
- e) Një përfaqësues mund të përfaqësojë vetëm një vend dhe mund të votoj vetëm në emër të tij.

9. Vendet e Unionit që nuk janë anëtarë të Këshillit ekzekutiv, marrin pjesë në takimet e tij në cilësinë e vëzhguesit.

10. Këshilli (Komiteti) ekzekutiv miraton rregulloren e tij.

Neni 15

1.a) Çështjet administrative të Unionit i kryen Byroja ndërkombëtare, që trashëgon Byronë e Unionit të bashkuar me Byronë e Unionit të themeluar me konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e veprave letrare dhe të artit.

b) Byroja ndërkombëtare në veçanti kryen punë të sekretariatit në organe të ndryshme të Unionit.

c) Drejtori gjeneral i Organizatës është funksionari më i lartë i Unionit dhe e përfaqëson atë.

2. Byroja ndërkombëtare i mbledh raportimet për mbrojtjen e pronësisë industriale. Çdo vend i Unionit ia komunikon Byrosë ndërkombëtare, sa më herët që është e mundur, tekstin nga çdo ligj të ri dhe të gjithë tekstet zyrtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pronësisë industriale. Ajo gjithashtu furnizon Byronë ndërkombëtare me ët gjitha botimet (publikimet) e shërbimeve të veta kompetente për fushën e pronësisë industriale që është në lidhje të drejtpërdrejt me mbrojtjen e pronësisë industriale, e për të cilat Byroja ndërkombëtare konsideron se janë të rëndësishme për punën e saj.

3. Byroja ndërkombëtare boton (shpall) revistë mujore.

4. Secilit vend të Unionit të Byrosë ndërkombëtare i dorëzon, me kërkesë të tij, njoftim për çështje në lidhje me mbrojtjen e pronësisë industriale.

5. Byroja ndërkombëtare merret me studime dhe ofron shërbime të dedikuara për lehtësimin e mbrojtjes së pronësisë industriale.

6. Drejtori gjeneral dhe personat që do t'i caktojë ai, marrin pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha seancat e Kuvendit, Këshillit ekzekutiv dhe çdo këshillit tjetër të ekspertëve apo grupi punues. Drejtori gjeneral ose ndonjë person që do të caktojë ai sipas detyrës zyrtare është sekretar i këtyre organeve.

7. a) Në bazë të udhëzimeve të Kuvendit, e në bashkëpunim me

Këshillin ekzekutiv, Byroja ndërkombëtare i përgatit konferencat për rishikim të dispozitave të Konventës, përveç të neneve nga 13 deri 17.

b) Për përgatitjen e konferencës për rishikim, Byroja ndërkombëtare mund të këshillohet me organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare.

c) Drejtori gjeneral dhe personat që do t'i caktojë ai marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e këtyre konferencave.

8. Byroja ndërkombëtare kryen të gjitha obligimet tjera që i janë dhënë (përcaktuar) .

Neni 16

1.a) Unioni ka buxhetin e tij.

b) Buxheti i Unionit përfshin të hyra dhe shpenzime personale të Unionit, kontribut i saj për buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta të Unionit, si edhe, në rast të nevojës, shumë e caktuar e lënë në dispozicion për buxhetin e Konferencës së Organizatës.

c) Si shpenzime të përbashkëta të Unionit konsiderohen shpenzimet që nuk i takojnë ekskluzivisht Unionit, por gjithashtu një apo më shumë unioneve që administrohen nga Organizata. Pjesëmarrja e Unionit në këto shpenzime të përbashkëta është relative me përfitimet (dobitë) që këto shpenzime përfaqësojnë për të.

2. Gjatë sjelljes së buxhetit të Unionit mbahet llogari për nevojat e bashkëpunimit me buxhetet e unioneve të tjera që i administron Organizata.

3. Buxheti i Unionit financohet nga burimet në vijim:

I) Kontributi i vendeve të Unionit;

II) Taksa dhe shuma për shërbimet që i ofron Byroja ndërkombëtare në emër të Unionit;

III) Të ardhura nga shitja e botimeve të Byrosë ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Unionin dhe të drejtat që rrjedhin nga këto botime;

IV) Dhurata, donacione dhe subvencione.

V) Të ardhura nga qiraja, interesi dhe të hyra të tjera.

4. a) Për të përcaktuar pjesën e kontributit për buxhetin e secilit vend të Unionit, ai vendoset në një klasë dhe i kryen kontributet e tij vjetore në bazë të disa njësive të përcaktuara si në vijim:

Klasa I -.....	25
Klasa II -.....	20
Klasa III-.....	15
Klasa IV-.....	10
Klasa V-.....	5
Klasa VI-.....	3

Klasa VII -..... 1

b) Nëse nuk e ka bërë këtë më herët, në momentin e deponimit të instrumentit të saj për ratifikim ose qasje, çdo vend specifikon klasën në të cilën dëshiron të vendoset. Ai mund të ndryshojë klasën. Nëse zgjedh klasë më të ultë të vendeve, për këtë duhet të njoftojë Kuvendin në një prej seancave të tij të rregullta. Ky ndryshim hyn në fuqi me fillimin e vitit pasues të kësaj seance.

c) Kontributi vjetor i çdo vendi përbëhet nga shuma që në raport me shumën e përgjithshme të kontributeve vjetore të të gjithë vendeve për buxhetin e Unionit, është i barabartë me raportin e numrit të njësive të klasës në të cilën është vendosur ai sipas numrit të përgjithshëm të njësive nga të gjitha vendet.

d) Kontributet shlyhen (paguhet) çdo vit më 1 janar.

e) Vendi që është me vonesë në pagesën e kontributeve të tij nuk mund të gëzojë të drejtën e tij të votës në asnjë organ të Unionit në të cilin është anëtarë, në qoftë se shuma e mbetur e papaguar është e barabartë ose më e madhe se kontributi që ka borxh për dy vite të plota të kaluara. Megjithatë, ai vend mund të autorizohet të mbajë të drejtën e votës në kuadër të atij organi aq gjatë derisa ky organ konsideron se vonesa rezulton nga rrethana të jashtëzakonshme dhe të pashmangshme.

f) Në qoftë se buxheti nuk do të ishte miratuar para fillimit të vitit të ri buxhetor, do të vazhdohet me buxhetin e vitit paraprak, në mënyrat e parashikuara me rregulloren financiare.

5. Lartësia e taksave dhe shumat e detyruara (që janë borxh) për shërbimet që i jep Byroja ndërkombëtare në emër të Unionit, i përcakton drejtori gjeneral i cili për këtë dorëzon raport në Kuvendin e Këshillit ekzekutiv.

6. a) Unioni disponon me fond qarkullues (punues) që formohet nga pagesat e vetme të çdo vendi të Unionit, nëse fondi bëhet i pamjaftueshëm, Kuvendi vendos për rritjen e tij.

b) Shuma e pagesës fillestare ët çdo vendi në fondin e cekur ose rritja e saj është proporcionale me kontributin e atij vendi për vitin gjatë të cilit krijohet fondi ose kur vendoset për rritjen e tij.

c) Kuvendi përshkruan raportin dhe mënyrat e pagesës me propozim të drejtorit gjeneral dhe sipas raportit të pranuar nga këshilli koordinues i Organizatës.

7. a) Në marrëveshjen për selinë, të arritur me vendin në territorin e të cilit Organizata do të ketë selinë e vet, parashihet që ky vend të jep avance në qoftë se fondi punues (qarkullues) do të ishte i pamjaftueshëm. Shuma e këtyre avanseve dhe kushtet nën të cilat miratohen janë propozim, në secilin rast të veçantë, i marrëveshjeve të veçanta midis vendit në fjalë dhe Organizatës. Derisa është e obliguar të miratojë avance, ky vend disponon me një ulëse *ex officio* në këshillin ekzekutiv.

b) Vendi nga nënparagrafi a) dhe Organizata, secili veçmas, kanë të

drejtë ta anulojnë obligimin për miratim të avanseve, përmes njoftimit me shkrim. Anulimi hyn në fuqi tre vite pas fundit të vitit në të cilin është njoftuar.

8. Vërtetimin e llogarive e kryejnë, në mënyrat e parapara me rregullore financiare, një ose më shumë vende të Unionit, ose kontrollorë të jashtëm të cilët, me pëlqimin e tyre, i emëron Kuvendi.

Neni 17

1) Propozime për ndryshim të neneve 13, 14, 15 dhe 16 dhe të këtij neni mund të sjellë çdo vend anëtarë i Kuvendit, Këshilli ekzekutiv ose drejtori gjeneral. Ky i fundit i komunikon këto propozime vendeve anëtare të Kuvendit të paktën gjashtë muaj para se të dorëzohen ato në shqyrtim në Kuvend.

2) Çdo ndryshim i neneve nga paragrafi 1 e miraton Kuvendi. Për miratim nevojitet shumicë prej tri të katërtave nga votat e dhëna; megjithatë, për çdo ndryshim të nenit 13 dhe të këtij paragrafi kërkohet shumicë prej katër të pestat e votave të dhëna.

3) Çdo ndryshim i neneve nga paragrafi 1 hyn në fuqi një muaj nga data kur drejtori gjeneral do të pranojë nga tri të katërtat e vendeve që janë anëtarë të Kuvendit në momentin kur është miratuar ndryshimi, njoftime me shkrim për pranim, të bëra në përputhje me rregullat e tyre përkatëse kushtetuese. Çdo ndryshim i tillë i miratuar i këtyre neneve i obligon të gjitha vendet që janë anëtarë të Kuvendit në momentin kur ndryshimi hyn në fuqi ose që do të bëhet anëtarë më vonë; megjithatë, çdo ndryshim me të cilin rriten obligimet financiare të vendeve të Unionit i obligon vetëm ata ndër të cilët kanë njoftuar pranimin e tyre për këto ndryshime.

Neni 18

1) Kjo konventë do t'i nënshtrohet rishikimeve për shkak të futjes së përmirësimeve të natyrës së tillë që do të përsosë sistemin e Unionit.

2) Për këtë shkak do të mbahen konferenca, një pas një, në një nga vendet e Unionit ndër përfaqësuesit e këtyre vendeve.

3) Për ndryshime të neneve nga 13 deri 17 vlejnë dispozitat nga neni 17.

Neni 19

Nënkuptohehet se vendet e Unionit mbajnë për vete të drejtën të nënshkruajnë në veçanti mes vete, marrëveshje të veçanta për mbrojtjen e pronësisë industriale, në qoftë se këto marrëveshje nuk do të ishin në kundërshtim me këtë konventë.

Neni 20

1. a) Çdo vend i Unionit që ka nënshkruar këtë Akt mund ta ratifikojë, e nëse nuk e ka nënshkruar mund të aderojë (qaset) në të. Instrumentet për ratifikim dhe aderim (qasje) deponohen tek drejtori gjeneral.

b) Çdo vend i Unionit mund të deklarojë në instrumentin e tij për ratifikim ose aderim, se ratifikimi ose aderimi i tij nuk zbatohen mbi:

I) Nenet nga 1 deri 12 ose

II) Nenet nga 13 deri 17.

c) Çdo vend i Unionit, i cili në pajtim me nënparagrafin b) përjashtohet nga veprimi në ratifikimin ose aderimin e tij një nga dy grupet e neneve nga ai nënparagrafi mund në çdo moment të mëvonshëm, të deklarojë se e zgjeron veprimin në ratifikimin ose aderimin e tij të këtij grupi të neneve. Kjo deklaratë deponohet tek drejtori gjeneral.

2. a) Në raport me dhjetë vendet e para të Unionit që i kanë deponuar instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim pa deklaratën të cilën e lejon paragrafi 1 nën 6) I), nenet nga 1 deri 12 hyjnë në fuqi tre muaj pas deponimit të instrumentit të dhjetë nga këto instrumente për ratifikim ose aderim.

b) Në lidhje me dhjetë vendet e para të Unionit që i kanë deponuar instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim pa deklaratën që e lejon paragrafi 1 nën b) II), nenet nga 13 deri 17 hyjnë në fuqi tre muaj pas deponimit të instrumentit të dhjetë nga këto instrumente për ratifikim ose aderim.

c) Nën rezervën e hyrjes fillestare në fuqi, në pajtim me dispozitat nga nënparagrafi a) dhe b), secili nga dy grupet e neneve nga paragrafi 1 nën b) I) dhe II) e nën rezervën e dispozitave nga paragrafi 1 nën b), nenet nga 1 deri 17 hyjnë në fuqi në lidhje me ndonjë vend të unionit, përveç ato nga nënparagrafi a) dhe b) që deponojnë instrumentin për ratifikim ose aderim, si dhe në raport me ndonjë vend të Unionit që deponon deklaratë duke zbatuar paragrafin 1 nën c), tre muaj pas datës së njoftimit nga ana e drejtorit gjeneral, për deponimin e tillë, përveç në qoftë se në vetë instrumentin ose në deklaratën e deponuar nuk është caktuar ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, ky akt hyn në fuqi në lidhje me at vend, në ditën e caktuar si të tillë.

3. Në lidhje me çdo vend të Unionit që deponon instrument për ratifikim ose aderim, nenet nga 18 deri 30 hyjnë në fuqi në ditën e parë kur njëri, cilido qoftë, nga grupet e neneve të paragrafit 1 pika b) do të hyjë në fuqi në raport me atë vend sipas paragrafit 2 pika a), b) ose c).

Neni 21

1. Çdo vend jashtë Unionit mund të aderojë në këtë akt dhe kështu të bëhet anëtare e Unionit. Instrumentet për qasje (aderim) deponohen tek drejtori gjeneral.

2. a) Në lidhje me çdo vend jashtë vendit që ka deponuar instrumentin e tij për aderim një muaj apo më shumë para datës së hyrjes në fuqi të dispozitave të këtij akti, ai hyn në fuqi në ditën kur dispozitat për herë të parë kanë hyrë në fuqi me zbatimin e nenit 20 paragrafi 2) nën a) ose b), përveç nëse në vetë instrumentin për aderim nuk është caktuar ndonjë datë e mëvonshme, megjithatë:

I) nëse nenet nga 1 deri 12 deri në atë ditë nuk kanë hyrë në fuqi, ky vend, gjatë periudhës kalimtare para hyrjes në fuqi të kësaj dispozite, në vend të tyre, do të jetë i obliguar me dispozitat nga nenet 11 deri 12 të aktit të Lisbonës.

II) nëse nenet nga 13 deri 17 deri në atë ditë nuk kanë hyrë në fuqi, ky vend, gjatë periudhës kalimtare para hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave, do të jetë i obliguar me nenet 13 dhe 14 paragrafi 3,4 dhe 5 të Aktit të Lisbonës.

Nëse ndonjë vend ka caktuar ndonjë datë të mëvonshme në instrumentin e tij të aderimit, ky akt, lidhur me atë vend, hyn në fuqi në atë datë të tillë të caktuar.

b) Në lidhje me ndonjë vend jashtë Unionit që ka deponuar instrumentin e tij të aderimit pas hyrjes në fuqi të vetëm një grupi të dispozitave të këtij akti, ose në ditën që i paraprinë për më pak se një muaj, ky akt hyn në fuqi, nën kushtet e parapara nën pikën a), tre muaj pas datës kur për aderimin ka njoftuar drejtori gjeneral, përveç nëse në instrumentin për aderim nuk është caktuar ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, ky akt hyn në fuqi, lidhur me atë vend, në atë datë të caktuar.

3. Në lidhje me ndonjë vend jashtë Unionit që ka deponuar instrumentin e tij për aderim pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Akti në tërësi, ose jo më pak se një muaj para asaj dite, ky akt hyn në fuqi tre muaj pas datës pasi që aderimin ta ketë njoftuar drejtori gjeneral, përveç nëse nuk është caktuar ndonjë datë e mëvonshme në instrumentin për aderim. Në rastin e fundit, ky akt lidhur me këtë vend hyn në fuqi në atë datë të caktuar si të tillë.

Neni 22

Përveç në rast të përjashtimeve të mundshme të parapara me nenin 20 paragrafi 1 pika b) dhe nenin 28 paragrafi 2, ratifikimi ose aderimi përfshin pajtueshmëri të plotë me ët gjitha dispozitat dhe gëzimin e të gjitha përparësive që i përshkruan ky akt.

Neni 23

Pas hyrjes në fuqi të këtij Akti në tërësi, një vend i caktuar nuk mund të aderojë në aktet e mëparshme të kësaj konvente.

Neni 24

1. Çdo vend mund, në instrumentin e tij për ratifikim ose aderim, të deklarojë, ose mund me shkrim të njoftojë drejtorin gjeneral kur do qoftë më vonë, se kjo konventë zbatohet mbi gjithë ose një pjesë të territoreve, të cekura në deklaratën ose njoftimin, për të cilin ajo është përgjegjëse në raportet e jashtme.

2. Çdo vend që jep deklarata të tilla ose ka bërë një njoftim të tillë, mund, në çdo moment, të njoftojë drejtorin gjeneral se kjo konventë pushon së zbatuari mbi gjithë ose një pjesë të këtyre territoreve.

3. a) Çdo deklaratë e bërë në kuptim të paragrafit 1 hyn në fuqi të njëjtën ditë si ratifikimi ose aderimi në instrumentin e të cilit është vendosur ajo, ndërsa çdo njoftim në kuptim të këtij paragrafi hyn në fuqi tre muaj pas njoftimit të drejtorit gjeneral.

b) Çdo njoftim i kryer në kuptim të paragrafit 2) hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pasi ta ketë pranuar drejtori gjeneral.

Neni 25

1) Çdo vend nënshkrues i kësaj konvente obligohet, në përputhje me kushtetutën e tij, të miratojë masa të nevojshme për sigurimin e zbatueshmërisë së kësaj konvente.

2) Nënkuptohe se në momentin kur një vend do të deponojë instrumentin e tij për ratifikim ose aderim, ai do të ketë mundësinë të zbatojë dispozitat e kësaj konvente në përputhje me legjislacionin e vet të brendshëm.

Neni 26

1) Kjo Konventë hyn në fuqi në kohë të pacaktuar (pafundësisht).

2) Çdo vend mund të anulohet (të tërhiqet) këtë akt me njoftim të drejtuar deri tek drejtori gjeneral. Ky anulim i pranohet gjithashtu, anulimet nga të gjitha aktet e mëparshme, ndërsa me ndikim është vetëm mbi vendin që dorëzon atë, derisa konventa mbetet në fuqi dhe zbatohet në raport me vendet tjera të Unionit.

3) Anulimi hyn në fuqi një vit pas ditës kur drejtori gjeneral ka pranuar njoftimin.

4) Me mundësinë për anulim të paraparë me këtë nen nuk mund të shërbehet vendi para skadimit të afatit prej pesë viteve duke llogaritur nga dita kur është bërë anëtare e Unionit.

Neni 27

1. Ky akt, në raportet midis vendeve mbi të cilat zbatohet, dhe nëse masën në të cilën zbatohet, zëvendëson konventën e Parisit të datës 2 mars të vitit 1883 dhe aktet e ardhshme të rishikuara.

2. a) Në lidhje me vendet mbi të cilat zbatohet akti, ose që nuk zbatohet në tërësi, por që mbi të cilin zbatohet Akti i Lisbonës së 31 tetorit të vitit 1958, ky i fundit mbetet në fuqi në tërësi, ose në qoftë se ky akt nuk e zëvendëson në kuptim të paragrafit 1.

b) Gjithashtu, në raport me vendet mbi të cilat nuk zbatohet asnjë akt, e as pjesë të tyre, as akti i Lisbonës, mbetet në fuqi Akti i Londrës i 2 qershorit të vitit 1934, në tërësi, ose në qoftë se ky akt nuk e zëvendëson në kuptim të paragrafit 1.

c) Gjithashtu, në raport me vendet mbi të cilat nuk aplikohet as ky akt e as pjesët e tij, as Akti i Lisbonës, e as Akti i Londrës, mbetet në fuqi Akti i Hagës i 6 nëntorit të vitit 1925 në tërësi, ose në qoftë se ky akt nuk e zëvendëson në kuptim të paragrafit 1.

3. Vendet e Unionit që do të nënshkruajnë këtë Akt e zbatojnë ndaj çdo vendi të Unionit që nuk është nënshkruar i këtij Akti ose që, edhe pse nënshkruar, ka dhënë deklaratën e paraparë sipas nenit 20 paragrafi 1 nën b) D). Këto vende e pranojnë vendin e Unionit në çështje për të zbatuar në marrëdhëniet e tyre me to, dispozitat nga akti më i ri në të cilin janë nënshkruar.

Neni 28

1) Çdo kontest midis dy apo më shumë vendeve të Unionit që ka të bëjë me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente, e që nuk do të zgjidhet me bisedime, cilido shtet në fjalë mund ta sjellë para gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë në bazë të kërkesës në linjë me Statutin e Gjykatës, përveç nëse vendet në fjalë nuk merren vesh për ndonjë mënyrë tjetër të zgjidhjes. Vendi që ka iniciuar kontestin do të njoftojë Byronë ndërkombëtare për kontestin e dorëzuar deri në Gjykatë, ai për këtë do të njoftojë vendet tjera të Unionit.

2) Çdo vend, në momentin e nënshkrimit të këtij akti ose të deponimit të instrumentit të tij për ratifikim ose aderim, mund të deklarojë se nuk llogaritet të jetë e obliguar me dispozitat e paragrafit 1. Sa i përket cilitdo kontest midis vendit të tillë dhe vendeve të tjera të Unionit, nuk do të zbatohen dispozitat e paragrafit 1.

3) Çdo vend që ka dhënë deklaratë në kuptimin e paragrafit 2, në çdo moment, mund ta tërheq përmes njoftimit të dërguar deri te drejtori gjeneral.

Neni 29

1. a) Ky akt është nënshkruar në një kopje të vetme në frëngjisht dhe është deponuar në Qeverinë e Suedisë.

b) Drejtori gjeneral, pas konsultimeve me palët e interesuara, do të hartojë tekste zyrtare në gjuhë gjermane, angleze, spanjolle, italiane, portugeze dhe ruse, si dhe në gjuhë të tjera që do t'i caktojë Kuvendi.

c) Në rast të kontestit për interpretimin e teksteve të ndryshme, teksti francez është i plotfuqishëm.

2. Ky akt mbetet i hapur për nënshkrim në Stokholm, deri më 13 janar të vitit 1968.

3. Dy kopje të shkruara nga teksti i nënshkruar i këtij akti, të vërtetuara nga Qeveria e Suedisë, drejtori gjeneral do t'i dërgojë deri tek qeveritë e të gjitha vendeve të Unionit, dhe me kërkesë, edhe deri tek qeveritë e do vendi tjetër.

4. Drejtori gjeneral do ta regjistrojë këtë akt në Sekretariatën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Drejtori gjeneral i njofton qeveritë e të gjitha vendeve të Unionit, për nënshkrimet, deponimet e instrumenteve për ratifikim ose aderim dhe deklaratat që përmbajnë këto instrumente ose që janë bërë në kuptim të nenit 20 paragrafi 1 pika c), hyrjen në fuqi të të gjitha dispozitave të këtij akti, njoftimet për anulim dhe njoftimet sipas nenit 20.

Neni 30

1) Deri në marrjen e detyrës së drejtorit të parë gjeneral, llogaritet se të gjitha referencat, sipas këtij akti, Byroja ndërkombëtare e Organizatës ose drejtori gjeneral, kanë të bëjnë me Byronë e Unionit respektivisht me drejtorin e tij.

2) Vendet e Unionit që nuk janë të obliguara me nenet nga 13 deri 17, gjatë pesë viteve nga hyrja në fuqi e Konventës për themelimin e Organizatës, mund të shfrytëzohen, nëse dëshirojnë, me të drejtat e parapara me nenet nga 13 deri 17 të këtij Akti sikur të jenë të obliguara me këto nene. Çdo vend që dëshiron të përdorë këto të drejta, për këtë qëllim deponon deri tek drejtori gjeneral njoftim me shkrim, që hyn në fuqi në ditën e pranimit. Për këto vende, konsiderohet se janë anëtare të Kuvendit deri në skadimin e kësaj periudhe.

3) Derisa të gjitha vendet e Unionit nuk bëhen anëtare të Organizatës, Byroja ndërkombëtare e Organizatës punon sikur Byro e Unionit, ndërsa drejtori gjeneral si drejtor i kësaj Byroje.

4) Kur të gjitha vendet e Unionit do të bëhen anëtare të Organizatës, të drejtat, obligimet dhe pronësia e Byrosë së Unionit kalon mbi Byronë ndërkombëtare të Organizatës.